

VENDIM
Nr.387, datë 31.5.2005

**PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË OBJEKTEVE TË
INSTITUTIT TË SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR, NGA MINISTRIA E
SHËNDETËSISË MINISTRISË SË DREJTËSISË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME
TË PËRMBARIMIT GJYQËSOR, ZYRA E PËRMBARIMIT, VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit të objekteve të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, dega Vlorë, nga Ministria e Shëndetësisë Ministrisë së Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbaarimit Gjyqësor, zyra e përmbaarimit, Vlorë, të përcaktuara në formularin nr.1, me numër rendor 1 dhe sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaarimit Gjyqësor, zyrës së përmbaarimit, Vlorë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve pronën e caktuar në këtë vendim.

3. Ngarkohen Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaarimit Gjyqësor dhe kryregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Vlorë

OBJEKTI : PLANIMETRIA E ZYRAVE NE PRONESI TE I.S.K.SH.

ADRESA : Lagjja " Kushtrim " , Rruga " Jonaq Kilica " , pallati nr. 563, shkalla nr.3, kati perdhe



OBJEKTI		ZYRAT E I.S.K.SH.	
PRONAR	I.S.K.SH.	SAMI CANAJ	NR. LICENSE A-0135
URBANIST	ARKITEKT	SAMI CANAJ	NR. LICENSE A-0135
FLETA	PLANIMETRIA		
		VLORË me c. 10.03/1995	